



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.02.2025

Nr: 136

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 24 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
KOALICIONIT PËR REFORMA INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA / KRIIK**

Sot më datë 22.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

- KËRKUES:** Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK
- SUBJEKT:** **Zj. Zhaneta Beqiri**
Drejtori i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia
Tiranë
- OBJEKT:** Lidhur me raportimin e pa plotë të një veprimtarie nga ana e Drejtorisë së
Kopshteve dhe Çerdheve Tiranë dhe përdorim i burimeve publike
- BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë
29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8,
pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

K O N S T A T O J :

Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK, më datë 19.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 24 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

Data: 22.02.2025

Nr: 136
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 24 ID, datë 19.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të KRIIK”

“Më datën 10 shkurt 2025, është zhvilluar në Tiranë një aktivitet për inagurimin e Kopshtit nr. 74, “Luleborë”. Sipas raportimit në faqen e KQZ-së, folës kryesor në këtë aktivitet ka qenë z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe pjesëmarrës jo diskutant zj. Zhaneta Beqiri, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve. Aktiviteti është transmetuar live në median televizive Tv News 24 dhe në faqen Facebook të Kryetarit të Bashkisë, z. Veliaj, nga ku konstatohet pjesëmarrja në cilësinë e folësve të dy deputetëve të Kuvendit të zgjedhur në Qarkun Tiranë, z. Plarent Ndreca dhe zj. Ermonela Felaj”.

Nga sa më sipër çmtoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S :

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Zhaneta Beqiri, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Tiranë
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI